

BASHKIA FIER

NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E KONTRATËS GJATË ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor:

Emri Bashkia Fier
Adresa Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15
Tel/Faks +355 34 410 650
E-mail prokurimetfier@gmail.com
Ueb-faqe www.app.gov.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri:L.Muskaj E-mail: prokurimetfier@gmail.com

3. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë “e hapur” mbi kufirin e lartë monetar.

Marreveshje Kuader me 1 (një) operator ekonomik – ku te gjitha kushtet jane te percaktuara – me afat 36 muaj.

4. Lloji i kontratës /Marreveshjes kuader: “Mall”

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF-35889-01-23-2025

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje (funizim/vendosje) materialeve të nevojshme për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme dhe shesheve të Bashkisë Fier”

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): “Asfalt, çakëll dhe rërë bitumi” 14213000-7, “Asfalt bitumi” 14213100-8.

8. Fondi limit / Vlëra e pritshme e kontratës/ve): 249 470 651.69 (dyqind e dyzet e nëntë milion e katërqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose fondi limit ne Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 23.01.2025): 2 538 366.41

(dy milion e pesëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje dyzetë e një) Euro.

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë: Kontrata është modifikuar bazuar në ligjin 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 127, pika 1, germa “c”, në të cilën citohet se: “kur modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike apo të marrëveshjes kuadër”, bazuar në urdhërin nr. 943/2 prot. datë 29.01.2026 “Për shtyrjen e afatit të furnizim-vendosjes për objektin: “Blerje (funizim/vendosje) materialeve të nevojshme për reabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme dhe shesheve të Bashkisë Fier” dhe në Relacionin nr. 943/1 prot. datë 26.01.2026, “Mbi kërkesën për shtyrje të afatit të kontratës nga sipërmarrësi i punime “G.P.G COMPANY” SHPK, për projektin “Blerje (funizim/vendosje) materialeve të nevojshme për reabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme dhe shesheve të Bashkisë Fier”, ardhur nga grupi i punës për ndjekjen e ecurisë së kontratës.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e shërbimeve:

- a. Bashkia Fier ka nënshkruar kontratën e furnizim-vendosjes nr. 930/38 prot., datë 25.06.2025, me kontraktor “G.P.G COMPANY” SHPK, për objektin “Blerje (funizim/vendosje) materialeve të nevojshme për reabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme dhe shesheve të Bashkisë Fier”.
- b. Furnizim-vendosja ishte parashikuar për tu kryer nga data e lidhjes së kontratës nr. 1 deri më datë 31.12.2025, si dhe Amendimit të Kontratës me nr. 14709/3 prot., datë 30.12.2025 “Për shtyrje të afatit furnizim vendosjes për objektin “Blerje (funizim/vendosje) materialeve të nevojshme për reabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme dhe shesheve të Bashkisë Fier”, përfundimi i furnizim vendosjes duhet të jetë më datë 30.01.2026.
- c. Brenda afatit të përcaktuar në paragrafin “b” si me lart, kontraktori, me shkresën datë 22.01.2026, protokolluar pranë Bashkisë Fier me nr.943 prot., me datë 23.01.2026, me lende “Kërkesë për shtyrje të afatit të kontratës”, informoi Autoritetin Kontraktor, Bashkia Fier, se arsyeja e mosrealizimit të punimeve në Njësinë Administrative Frakull, me shtresat përkatëse satbilizant, binder dhe asfaltobeton, nga ana e kompanisë “G.P.G COMPANY” SHPK, janë kushtet e pafavorshme atmosferike dhe prej datës 7 janar e në vazhdim, veçanërisht përmbytjet e evidentuara nga Bashkia Fier në këtë zonë administrative.

Me shkresën datë 22.01.2026, të Subjektit Sipërmarrës protokolluar pranë Bashkisë Fier me nr.943 prot., me datë 23.01.2026, me lende “Kërkesë për shtyrje të afatit të kontratës”, është kërkuar shtyrje të afatit deri më datë 15.03.2026.

Sa më lart, nga Drejtoria e Programimit dhe Kontrollit të Punëve Publike e Investimeve, si Drejtori përkatëse e ndjekjes së zbatimit të kësaj kontrate, pasi është analizuar kërkesa e kontraktorit, është vlerësuar e nevojshme shtyrja e afatit të kësaj kontrate për realizimin e sasisë së zërave të mbetur deri më datë 20.02.2026,

PËR SA MË LART, palët bien dakord si më poshtë:

1. Periudha e zbatimit të kontratës shtyhet për një periudhë 21-ditore (nga data 31.01.2026 deri në datën 20.02.2026).
2. Vlefshmëria e këtij Amendamenti shtrihet për një periudhë 21-ditore (nga data 31.01.2026 deri në datën 20.02.2026), në mbështetje të argumenteve të paraqitura nga kontraktori dhe miratuar nga Investitori.

3. Për periudhën, për të cilën kërkohet shtyrja e afatit të kontratës, kontraktori merr përsipër të bëjë sigurimin e kontratës, e cila do të jetë e vlefshme për periudhën që kërkohet në këtë amendim kontrate.
4. Të gjithë kushtet e tjera të kontratës së lidhur nr. 930/38 prot., datë 25.06.2025, mbeten të pandryshuara.

Data e nënshkrimit të modifikimit: 29.01.2026.

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: 65 546 250 (*gjashtëdhjetë e pesë milion e pesëqind e dyzetë e gjashtë mijë e dyqind e pesëdhjetë*) lekë pa TVSH dhe 78 655 500 (*Shtetëdhjetë e tetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e peseqind*) lekë me TVSH.

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): nuk aplikohet

13. Kohëzgjatja e kontratës: nga data e lidhjes së kontratës nr. 1 deri më datë 31.12.2025, referuar amendimit nr. 14709/3 prot., datë 30.12.2025 “ Për shtyrje të afatit furnizim vendosjes për objektin “Blerje (furnizim/vendosje) materialeve të nevojshme për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme dhe shesheve të Bashkisë Fier”, përfundimi i furnizim vendosjes duhet të jetë më datë 30.01.2026.

14 Dhe afati i ri (nëse është rasti): 21-ditë (nga data 31.01.2026 deri në datën 20.02.2026).

15. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomikë:

“G.P.G. COMPANY” SHPK, me NUIS J64324443V

Adresë: Fier, Lushnje, Lagjja “18 Tetori”, godinë 1 katëshe, tek nyja e prodhimit Asfalto-Betonit, pranë Rotondos së Plukut Fier.

Tel/Fax 0692080852

E-mail E-mail: gpgkompani@gmail.com

Faqja e Internetit _____

15. Data e nënshkrimit të modifikimit : 29.01.2026

16. Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë Fier.

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti kontraktor _____